

URBANISM WATCHUrbanizmi i Prizrenit nën
vëzhgim të përhershëm

7 maj 2015, Prizren

Komunikatë #22

KOMUNIKATË PËR MEDIA**Publikohen të dhënat statistikore mbi (Pa)drejtësinë në Urbanizmin e Prizrenit**

EC Ma Ndryshe ka publikuar analizën e shkurtër “(Pa)drejtësia në Urbanizmin e Prizrenit?”, ku me anë të dhënave statistikore tregohet dështimi i institucioneve në zbatimin e legjislacionit të hartuar dhe miratuar me qëllim të ruajtjes së Qendrës Historike të Prizrenit.

Analiza konstaton se thirrjet e publikut për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit nuk po merren parasysh nga institucionet e pushtetit ekzekutiv e legjislativ si në nivelin lokal ashtu edhe atë qendror, sikurse edhe gjyqësori.

Këto institucione, që kanë detyrime të qarta ligjore për të vepruar për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore e historike në këtë Qendër prej vitesh kanë vendosur që t’i mbyllin sytë dhe veshët kundruall degradimit urbanistik në këtë zonë të veçantë të qytetit të Prizrenit, duke instaluar në mënyrë të heshtur kulturën e pandëshkueshmërisë.

Ky konstatim i EC Ma Ndryshe, i dokumentuar me raste konkrete përgjatë më shumë se dy vitesh konfirmohet edhe nga të dhënat statistikore të grumbulluara në fund të vitit të kaluar nga institucionet përgjegjëse, që kanë shërbyer për hartimin e analizës statistikore “(Pa)drejtësia në Urbanizmin e Prizrenit?”, e cila është ilustruar shkurt edhe përmes një infografi.

Të dhënat e pasqyruara në analizë dhe infograf mjaftojnë për të përshkruar edhe njëherë me shifra dështimin e institucioneve në zbatimin e ligjit në Qendrën Historike të Prizrenit.

Më shumë hollësi mund të gjeni në analizë, të cilën mund ta gjeni në këtë link [http://online-transparency.org/repository/docs/Analiza_\(Pa\)drejtesia_ne_urbanizmin_e_Prizrenit.pdf](http://online-transparency.org/repository/docs/Analiza_(Pa)drejtesia_ne_urbanizmin_e_Prizrenit.pdf) dhe në infograf që mund ta gjeni bashkangjitur.

Pos këtyre publikimeve, EC Ma Ndryshe ka përditësuar edhe hartën e parregullsive urbanistike në Prizren, të cilën mund ta gjeni në këtë link: <http://www.online-transparency.org/harta/>

“EC Ma Ndryshe” në korrik të vitit 2013 ka nisur zbatimin e projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”, përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Projekti do të vazhdoj me monitorimin dhe publikimin e të gjeturave në sektorin e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor, sikurse edhe me adresimin e përgjegjësisë institucionale.

Me nderime,

Valon Xhabali, Koordinator i Projektit
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren &
Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-.5, 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771

URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën

vëzhgim të përhershëm

përkrahët financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo